



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,
Ref:13.07.2017\561-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Blerim Devolli- Devolli Group kundër Kosovës Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Vëllezërit Devolli e kanë zhvendosur pasurinë në parajsën fiskale" të datë 13.07.2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet pjesërisht

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se "Shkëlqim dhe Blerim Devolli janë maja e krimit ekonomik, korrupsionit dhe shpërlajres së parasë". Duke pohuar se Devollët kanë krijuar pasuri në mënyrë të pandershme dhe bartin para në "parajsa financiare jashtë vendit".

Në ankesë shtohet se në këtë mënyrë dëmtohet imazhi i kompanisë.

Ankesa kundërshton këto epitete dhe thekson se artikulli pa fakte konkrete ka njëlloshur kompaninë, duke shkelur Kodin e Mediave të Shkruara.

Gjithashtu në ankesë thuhet se gazeta Kosova Sot nuk iu ka mundësuar Devollëve të prononcohen lidhur me akuzat që u bëhen atyre, me çka është shkelur Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur).

KMShK pasi shqyrtoi artikullin dhe ankesën konstatoi se në rastin konkret është shkelur Kreu II (Raportimi i së vërtetës) dhe Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të Mediave të Shkruara.

Opinionin u nxor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionin.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës